

Shkollat e Promocionit Shëndetësor

Në Europë e më gjerë flitet shumë për Shkollat të Promocionit Shëndetësor, si një alternativë ideale për ndryshimin e stilit të jetës së fëmijëve që mësojnë në to dhe stafit që punon në këto mjedise. Kjo ide gjeniale ka filluar që nga vitet 80-të, dhe në vendin tonë filloi të përmendej nga mesi i viteve 90-të. Është folur shumë dhe është punuar shumë në këtë drejtim, por cilat janë tiparet e një shkolle që promovon shëndet sipas OBSH-së?

Shkollat që promovojnë shëndet synojnë:

-Të parashikojnë një mjedis të sigurtë dhe të shëndetshëm në problemet që lidhen me ushqimin, me ndërtime, sheshet sportive, vendet e kohës së lirë, etj.



-Të promovojnë një sens përgjegjësie për shëndetin e individit, familjes dhe komunitetit.

-Të prezantojnë një gamë realiste dhe tërheqëse të zgjedhjeve shëndetësore në mënyrë që të inkurajojnë një mënyrë jetese të shëndetshme.

-Të promovojnë vetëvlerësim nga nxënësit, duke i aftësuar ata të plotësojnë potencialet e tyre fizike, psikologjike dhe sociale.



-Të sqarojnë qëllimet sociale të shkollës dhe të ndriçojnë potencialet e saj për promocionin shëndetësor.

-Të zhvillojnë marrëdhënie të mira interpersonale ndërmjet komunitetit të brendshëm dhe të jashtëm të shkollës.

-Të përdorë potencialin e specialistëve dhe burimeve të tjera të komunitetit për të parashikuar këshilla dhe mbështetje në edukimin shëndetësor dhe veprimin për promocionin shëndetësor;

-Të planifikojë një kurrikulum koherent për edukimin shëndetësor.



-Të parashikojë krijimin e një baze të dhënash për informimin shëndetësor dhe një sërë mjeshtërisht për përfitimin, interpretimin dhe përhapjen e këtij informacioni.